

Fillimi > -Kronikë

Breshëri plumbash ndaj makinës në Elbasan, babë e bir i shpëtojnë mrekullisht atentatit. Ja çfarë deklaruan në polici

21 Qershor, 2020 13:22 |



Madhësia e tekstit: - +

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar pas mesnatës së kaluar në fshatin Byshek të Elbasanit. Policia bën me dije se është qëlluar në drejtim të një makine, ku udhëtonin babë e bir.

Gazetarja Dorjana Bezat raporton për “**BalkanWeb**” se është qëlluar me armë 48-vjeçari Petrit Çarçiu, të cilit më herët i kanë djegur edhe lokalin që ka në pronësi.

Ndërkohë, siç raporton gazetarja Bezat, i pyetur në polici mbi ngjarjen e natës së kaluar, Çarçiu ka thënë se është qëlluar me armë nga një këmbësor. Ndërkohë, nga të shtënat fatmirësisht nuk ka pasur asnjë të lënduar, por vetëm dëme materiale.

Njoftimi i policisë:

Rreth orës 00:30, në fshatin Byshek, Elbasan, shtetasi P.Ç, banues në fshatin Shushicë, Elbasan ka njoftuar Sallën Operative të DVP Elbasan se në rrethana ende të paqarta është qëlluar me armë zjarri në drejtim të mjetit të tij i cili udhëtonte sëbashku me djalin.

Nga të shtënat nuk ka asnjë të plagosur por vetëm dëme materiale të mjetit me të cilët udhëtonin shtetasit e lartpërmendur. Shërbimet e Policisë vijojnë punën për sqarimin dhe zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit.

(BalkanWeb)

Për t’u bërë pjesë e grupit “**Balkanweb**” mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Elbasan Petrit Çarçiu te shtena me arme

TË NGJASHME



Ngjarje e rëndë në Elbasan, 31 vjeçari hidhet nga kati i katërt i pallatit. Ndërron jetë në vend

22 Qershor, 2020



E qëlluan me armë, kush është 48-vjeçari që iu dogj 3 herë lokali, problemet me dy ish-gratë dhe dënimi i vëllezërve për drogë

21 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




Goditën me grushte të riun e prangosur, pezullohen nga detyra dy efektivë, Policia e Shtetit: Ja si ndodhi ngjarja

22 Qershor, 2020




I moshuari qëllohet me grushte dhe grabitet në mes të Tiranës, aventura e autorit përfundon me kaq

22 Qershor, 2020



Polici godet me grushte në fytyrë të riun e prangosur, ndërhyjnë kolegju për... (VIDEO)

22 Qershor, 2020



Shqiptari vret me thikë tunizianin në Romë, u arrestua pasi u kap duke shëtitur në rrugë

22 Qershor, 2020



EMRI/ Shqiptari humb tragjikisht jetën në Itali, po zëvendësonte disa tjegulla në derën e ndërtesës kur...


22 Qershor, 2020



Ndotën ajrin duke djegur mbeturina, procedohen penalisht dy persona te Gjiri i Lalzit


22 Qershor, 2020

KATEGORIA VIDEO



Deputeti i dytë shqiptar nga lista “Lugina e Bashkuar”: E papranueshme një marrëveshje Kosovë- Serbi që na ndan

22 Qershor, 2020



Videoja e dhunës së policit ndaj një të ndaluar, Ina Zhupa: Me këtë sjellje Europa na heq vizën e kuqe

22 Qershor, 2020



Debat në ‘Real Story’, Lubonja: O Baton s’po të kuptoj, vetëm ti je te ndryshimi i kufijve se as Thaçi s’guxon ta thotë!

22 Qershor, 2020



Arben Çejku: Vuçiç shkon në Moskë para Uashingtonit, merr “ok” për marrëveshjen me Kosovën!

22 Qershor, 2020



Marrëveshja Kosovë- Serbi/ Lubonja: Vuçiç do kërkojë të marrë diçka, ja pse BE është kundër shkëmbimit të territoreve

22 Qershor, 2020



Diplomati rendit arsytet që i dhanë fitoren Vuçiç: Ndryshimet që pësoi Serbia gjatë qeverisjes së tij

22 Qershor, 2020